



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
TIRANË

Nr. Regj. Them. **8237/5667/1493**
Data e regjistrimit 03.04.2015

Vendimi Nr. **3621**
Data e vendimit 12.09.2017

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga Gjyqtarët:

BARI SHYTI	-	Kryesues
LINDITA SINANAJ	-	Anëtare
AMARILDO LAÇI	-	Anëtar

Asistuar nga sekretare **Klodeta Zhgjuni** në Tiranë më datën 12.09.2017, përfundoi shqyrtimin në dhomë këshillimi të çështjes administrative me Nr. 8237/5667/1493, Regjistri Themeltar me palë e objekt si vijon:

PADITËS: Shoqëria “Banka Credins” sh.a, me adresë Rr. “Ismail Qemali”, Nr. 21, Tiranë, përfaqësuar me autorizim nga Av. Taulant Jorgji.

E PADITUR: Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

OBJEKTI:

1. Shfuqizimi i vendimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit datë 21.10.2014 për pezullimin e aplikimit me numër çështje CN-669048-10-14, si dhe i shkresës nr. 12738/1, datë 06.11.2014 të Drejtorit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për mospranimin e ankimit administrativ.
2. Detyrimi i Qendrës Kombëtare për të regjistruar dhe pasqyruar në regjistrin tregtar kontratën e dhurimit të aksioneve datë 15.09.2014 lidhur midis Ervin Bushati dhe Vjollca Bushati, si dhe lëshimi i vërtetimit të kryerjes së këtij veprimi.

BAZA LIGJORE:

Neni 116 dhe 118, të Kushtetutës së RSH; Neni 9, 115/b dhe 118, të Kodit të Procedurave Administrative; Neni 4, 43, 70, 71, të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”; Neni 15/a, 17/9, 38, të Ligjit Nr. 49/2012; Nenet 4, 6, 27, 37, 78, 79, 87, 105, 115 dhe 123, të Ligji Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”; Neni 118, 119 dhe 228, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 223, datë 27.01.2015 ka vendosur:

- *Rrëzimin e padisë.*
- *Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.*
- *Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit, ndërsa për palën në mungesë ky afat fillon nga e nesërmja e marrjes dijeni.*

Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankimi pala paditëse Shoqëria “Banka Credins” sh.a. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka shqyrtuar kushtet e pranueshmërisë së ankimit të palës paditëse, me vendim të vecantë, ka vendosur pranimin e ankimit dhe ka përcjellë aktet për kompetencë funksionale Gjykatës Administrative të Apelit.

Pala paditëse Shoqëria “Banka Credins” sh.a përmes ankimit të paraqitur, kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e kërkesë padisë, duke parashtruar këto shkaqe në ankim:

- ✓ Vendimi i gjykatës në tërësinë e tij nuk është një unitet në pjesët përbërëse të arsyetimit dhe shkaqeve ligjore, që kanë krijuar bindjen e brendshme të gjykatës. Ky është një vendim që ka dhënë një pasqyrë subjektive dhe të njëanshme të interpretimit të ligjeve të mësipërme.
- ✓ Në asnjë rresht të saj gjykata nuk ka arritur të “gjej” se cila është dispozita e ligjit (jo udhëzimit) që ngarkon shoqërinë “Banka Credins” sh.a, me detyrimin që përpara se të depozitojë një transaksion tregtar (transferim aksionesh në rastin konkret) në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ajo është e detyruar të regjistrohet përpara pranë Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve.
- ✓ Në fakt, gjykata në kundërshtim me nenin 126 dhe 29, të K.Pr.Civile nuk merr në analizë dhe nuk arsyeton asnjë rresht në lidhje me faktin se vetë ligji i posaçëm, i detyrueshëm për zbatim nga i padituri (QKR) nuk parashikon një ndërvare si të detyruar regjistrimi. Në fakt ky detyrim i paligjshëm buron nga një akt nënligjor i paligjshëm, siç është udhëzimi

nr. 309, datë 03.06.2014 “Për regjistrimin e titujve në shoqërinë “Qendra e Regjistrimit të aksioneve” sh.a, Tiranë.

- ✓ Gjykata, në zbatim të gabuar të nenit 35, të ligjit nr. 49/2012, arsyeton se paditësi nuk vërtetoi mosazhornimin e shoqërisë “Qendra e regjistrimit të aksioneve” sh.a. pranë Regjistrimit Tregtar, regjistër ky që mbahet dhe administrohet nga i padituri QKR. Ishte ky i fundit që duhet t’i provonte gjykatës legjitimitetin e Qendrës së regjistrimit të aksioneve në ushtrimin e funksioneve të kërkuara nga udhëzimi nr. 309, datë 03.06.2014 “Për regjistrimin e titujve në shoqërinë “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a. Tiranë, përse kohe që e gjithë procedura e regjistrimit është pezulluar nga QKR me të vetmin arsyetim se QRA është subjekti i liçencuar konform ligjit, ku Banka Credins duhet të regjistrohet paraprakisht.
- ✓ Ndërkohë që, si Qendra Kombëtare e Regjistrimit ashtu edhe gjykata në funksion të Kushtetutës së RSH, duhet të vlerësojnë nëse aplikimi për çështjen CN-669048-10-14 është ose jo në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 03.07.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”.
- ✓ Në të gjitha rastet regjistrimi në Regjistrin Tregtar pranë QKR as nuk paraprihet dhe as nuk ndërvarret si parakusht nga ndonjë regjistrim pranë Qendrës së regjistrimit të aksioneve, siç parashikohet në urdhërin nr. 306, datë 03.06.2014 “Për regjistrimin e titujve në shoqërinë “Qendra e regjistrimit të aksioneve” sh.a. Tiranë.
- ✓ Për më tepër, ligji përcakton se me dorëzimin e bilancit Banka njofton (por jo regjistron sipas udhëzimit të mësipërm), listën e aksionerëve të saj që normalisht kjo listë nxirret në formën e ekstraktit nga regjistri i aksioneve që ajo mban si shoqëri tregtare, konform nenit 119 të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
- ✓ Pezullimi i aplikimit për regjistrimin e kontratës së dhurimit të aksioneve, bazuar vetëm në argumentin dhe referencën në udhëzimin nr. 309, datë 03.06.2014 "Për regjistrimin e titujve në shoqërinë "Qendra e regjistrimit të aksioneve" sh.a. Tiranë, i cili është një akt nënligjor i nxjerrë nga ana e Ministrit të Zhvillimit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, përbën cënim të parimit të ligjshmërisë.
- ✓ Bazuar në parimin e ligjshmërisë, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në cilësinë e organit administrativ është e detyruar që të aplikojë drejtpërdrejtë ligjin e posaçëm hierarkik më të lartë, përse kohë që vetë udhëzimi nr. 309, datë 03.06.2014, është një akt nënligjor i paaplikueshëm për shkaqet e renditura në këtë padi.
- ✓ Gjykata Kushtetuese me vendimet e saj nr. 9, datë 01.04.2009 dhe nr. 23, datë 08.06.2011 është shprehur se: *“Gjykata vlerëson, se sipas parimit të hierarkisë së normave juridike, përcaktuar në nenin 116, të Kushtetutës, aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, më pas vijojnë ligjet dhe së fundmi aktet normative të Këshillit të Ministrave. Prandaj, në rast përplasjesh dhe dualizimesh midis procedurave të përcaktuara me ligj dhe atyre të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave si akt normativ, prioritet ka*

ligji” (Vendimi nr. 9, datë 01.04.2009). “Ky parim (hierarkia e normave juridike në rastin konkret) detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material”. (Vendimi nr.23, datë 08.06.2011).

- ✓ Gjykata e Shkallës së Parë ka konsideruar se nuk ka kompetencë funksionale për të vlerësuar nëse udhëzimi nr. 309, datë 03.06.2014 është i autorizuar nga ana e ligjit të posaçëm, prandaj për këtë arsye ja parashtrojmë këtë kërkim Gjykatës Administrative të Apelit për të vlerësuar si një fakt thelbësor në pavlefshmërinë e këtij urdhëri.
- ✓ Udhëzimi nr. 309, datë 03.06.2014 "Për regjistrimin e titujve në shoqërinë "Qendra e regjistrimit të aksioneve" sh.a. Tiranë, jo vetëm që krijon norma të reja detyruese përtej kufijve dhe kompetencave të përcaktuara në ligjet referuese, duke tejkalluar në kundërshtim me Kushtetutën qëllimin dhe kufijtë e rregullimit ligjor, por për më tepër ligjet referuese (ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 119, ligji "Për qendrën kombëtare të regjistrimit" si dhe ligji "Për titujt") nuk përcaktojnë organin që legjitimohet të nxjerrë këtë akt nënligjor, si dhe parimet bazë që do të rregullohen nëpërmjet këtij akti nënligjor.
- ✓ Vetë paragrafi i fundit (5) i nenit 119 nuk krijon asnjë lloj varësie me regjistrime paraprake tek ndonjë qendër tjetër regjistrimi, ashtu siç pretendohet nga ana e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në vendimin e saj të pezullimit datë 21.04.2014. Sidoqoftë regjistrimi pra një qendre të specializuar (Regjistrar) është një veprim paralel, që nuk interferon me depozitimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- ✓ Konform nenit 118, të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Banka Credins emeton dhe administron vetëm titujt/ aksionet me ofertë private. Këto lloj titujsh që përfshihen në kategorinë e titujve të materializuar nuk kanë detyrimin për t'u tregtuar nëpërmjet regjistrimit të tyre elektronik, gjë që është karakteristike për titujt e dematerializuar. Pra, aksionet e emetuara në formën e ofertës private dhe që kanë formën e tyre të materializuar nuk tregtohen në tregjet publike, pasi nuk janë pjesë e ofertës publike dhe transaksioneve në "Bursë".
- ✓ Sipas Ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt", në regjistrar regjistrohen titujt e dematerializuar, të cilët përfshihen në sisteme regjistrimi dhe janë të tregtueshëm në bursë nëpërmjet ofertës publike. Në rastin konkret, aksionet e emetuara nga ana e Bankës Credins janë ato me ofertë private, të cilat janë në formë të materializuar dhe që transferimi i tyre është i ndërvarur nga miratimi i organeve vendimarrëse të shoqërisë apo ato ligjore.
- ✓ Ky regjistrat i titujve detyrimisht duhet të jetë i licensuar nga Autoriteti (AMF) për llojin e titujve që administron dhe regjistron, pasi të jetë rregullisht i regjistruar si person juridik pranë Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, fakt ky që nuk përmbushet nga ana e QRA.

- ✓ Nuk është përcaktuar në ligjin "Për titujt" që ky regjistrar të jetë pikërisht Qendra e Regjistrimit të Aksioneve. Për më tepër, shoqëria aksionere "Qendra e Regjistrimit të Aksioneve" sh.a, nuk rezulton të jetë as rregullisht e azhurnuar pranë regjistratit tregtar dhe as e liçensuar nga ana e AMF, për veprimtarinë e regjistrimit të titujve.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Si dëgjoi relatimin e çështjes nga gjyqtari Bari Shyti, analizoi aktet dhe shkaqet e ankimit, si bisedoi në tërësi çështjen:

V Ë R E N

Se, ankimi i paraqitur nga pala paditëse, nuk përmban shkaqe ligjore që motivojnë cënimin e vendimit nr. **223, datë 27.01.2015**, te Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për rrjedhojë ky vendim duhet të lihet në fuqi si një vendim i drejtë, në respektim të ligjit procedural e material.

Duke e vlerësuar rëndësinë që ka e drejta për një proces të rregullt ligjor, Gjykata Administrative e Apelit, në konsideratë të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ, vuri në diskutim para së gjithash, ligjshmërinë e gjykimit në shkallë të parë sipas standartit kushtetues për një proces të rregullt ligjor. Në konceptim të procesit të rregullt ligjor, gjykata vlerësoi nëse ka pasur shkelje të rregullave mbi kompetencën dhe juridiksionin parashikuar nga nenet 7-12 të ligjit nr. 49/2012, të rregullave që përcaktojnë kushtet e pranueshmërisë së ankimit, si dhe të rregullave që sjellin pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit, konstatimi i të cilave do të çonte në pamundësinë e kësaj gjykate për të dhënë një vendim përfundimtar mbi themelësinë e pretendimeve të palëve.

Në vlerësim të sa më sipër, ky kolegji nuk evidentoi cënim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, prandaj, bazuar në nenin 49, të Ligjit Nr. 49/2012, u procedua me gjykim mbi aktet e administruara nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykimi i çështjes përfundoi në dhomë këshillimi, ku ky kolegji, i'u dha përgjigje pretendimeve të ngritura në ankim nga pala ankuese pasi i ballafaqoi ato me faktet e çështjes dhe kuadrin ligjor të zbatueshëm.

I. Rrethanat e Çështjes

- *Sipas rrethanave të çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit nga gjykata e shkallës së parë, duke i'u referuar akteve shkresore të administruara në gjykim në shkallë të parë, rezulton se:*

Pala paditëse shoqëria "Banka Credins" sh.a, është një shoqëri tregtare anonime, e regjistruar në QKR me NIPT K31608801O, me seli qendrore në Tiranë, në Rrugën "Ismail Qemali", Nr. 21, e përfaqësuar ligjërisht nga Maltin Korkuti, me objekt të veprimtarisë së saj në fushën e bankare dhe financiare, të gjitha format e kredidhënies duke përfshirë edhe kredinë konsumatore e kredinë hipotekore, faktoringu dhe financimin e transaksioneve financiare, qiranë financiare, të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, duke përfshirë kartat e kreditit dhe të debitit, çeket e udhëtareve, çeket bankare dhe kartat e pagesës, etj.

Një prej aksionerëve të kësaj shoqërie është dhe z.Ervin Bushati, i cili është zotërues i paketës prej 75.801 të aksioneve. Këtë paketë aksionesh ia ka dhuruar znj.Vjollca Bushati, nëpërmjet kontratës së dhurimit të aksioneve të datës 15.09.2014.

Në datë 10.10.2014, shoqëria "Banka Credins" sh.a, ka aplikuar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, për depozitimin në regjistrin tregtar të kësaj kontrate dhurimi.

Rezulton se nga ana e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit është marrë vendimi për pezullimin e aplikimit, me argumentin se: *"Bazuar në udhëzimin nr. 309, datë 03.06.2014, duhet të paraqitet në rast transferimi të aksioneve, lista e plotë e aksionerëve me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative nga shoqëria "Qendra e Regjistrimit të Aksioneve" sh.a. Tiranë; Të paraqitet dokumenti i identifikimit të aksionerit të ri."*

Ndaj vendimit për pezullimin e aplikimit, shoqëria "Banka Credins" sh.a, ka paraqitur kërkesën ankimore të datës 31.10.2014, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, i cili me shkresën nr. 12738/1, datë 06.11.2014 "Kthim Përgjigje", i ka kthyer përgjigje shoqërisë për arsyet e marrjes së vendimit për pezullimin e aplikimit duke parashtruar të njëjtat arsye si në vendimin e pezullimit.

Pala paditëse shoqëria "Banka Credins" sh.a, duke mos qenë dakort me aktet e mësipërme, me anë të të cilave është pezulluar aplikimi për depozitimin në regjistrin tregtar të kontratës së dhurimit, për rivendosjen e të drejtës së cënuar, me datë 01.12.2014 i është drejtuar gjykatës me kërkesë padi.

- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka shqyrtuar mosmarrëveshjen, ka rrezuar kërkesë padinë duke arsyetuar ndër të tjera se:**

Në rastin konkret, aksioneri Ervin Bushati, ka transferuar nëpërmjet kontratës së dhurimit, paketën prej 75.801 të aksioneve tek znj.Vjollca Bushati. Ky transferim kërkon ruajtjen si e dhënë elektronike në regjistrat e titujve, konform nenit 6, të ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt". Përkufizimi i regjistrarit të titujve dhe funksionet e tij, jepen nga neni 123 dhe 126, të ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Per titujt".

Në nenin 123 të këtij ligji parashikohet: "Përkufizimi".

"Regjistrari i titujve, ose shkurt regjistrari, është shoqëria aksionere e licencuar nga autoriteti, që ka për objekt të veprimtarisë organizimin dhe administrimin e të dhënave për titujt.

Regjistri i titujve nuk mund të kryejë veprimtari të tjera, të ndryshme nga veprimtari për të cilat liçenohet nga autoriteti.

Regjistri i titujve është dokumenti zyrtar dhe ligjor, i mbajtur në një formë të caktuar, i cili përmban të dhëna për pronësinë mbi titujt, me transaksionet e kryera në lidhje me to apo të dhëna për vendosjen e titujve si garanci.

Regjistri i veçantë emërtohet në varësi të llojit të titujve, për regjistrimin e të cilit synon veprimtaria e regjistrarit.

Regjistri mund të liçenohet për të regjistruar një ose më shumë tituj të përcaktuar.

Në emërtimin e regjistrarit vendoset në kllapa emërtimi i titujve, për të cilët është licencuar për të operuar”.

Në nenin 126 të këtij ligji parashikohet: “Funksionet e regjistrarit”.

“Regjistri, në varësi të titujve, për të cilët është licencuar, ka si funksion ofrimin e shërbimit të regjistrimit të titujve, nëpërmjet organizimit të mënyrës së mbajtjes së regjistrarit, në mënyrë të tillë që të sigurohen në çdo kohë të dhëna të plota për pronësinë mbi titujt, si dhe kufizime të të drejtave të pronësisë mbi to.

Për realizimin e funksioneve të veta, regjistri ka për detyrë:

1. Të organizojë regjistrimin e transaksioneve dhe të ndryshimeve përkatëse, në mënyrë që të evidentojë, në çdo kohë, të dhëna mbi zotëruesin e fundit të titujve dhe kushteve, që çojnë në kufizim të të drejtave të pronësisë mbi titujt”.

Pra, një nga funksionet e regjistrarit është organizimi i regjistrimit të transaksioneve dhe të ndryshimeve përkatëse, në mënyrë që të evidentojë në çdo kohë, të dhëna mbi zotëruesin e fundit të titujve dhe kushteve që çojnë në kufizim të të drejtave të pronësisë mbi titujt.

Kuptimin e transaksioneve mbi titujt e jep neni 124, i ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, sipas të cilit: “Transaksion mbi titujt quhet transferimi me apo pa shpërblim i pronësisë mbi të drejtat e mbartura nga titujt.”

Në këndvështrim të kësaj dispozite, aksioneri Ervin Bushati, ka transferuar nëpërmjet kontratës së dhurimit, paketën prej 75.801 të aksioneve tek znj.Vjollca Bushati. Ky transferim aksionesh kërkon regjistrimin në regjistrat e titujve, prej regjistrarit “Qendrës së regjistrimit të aksioneve” sh.a. Tiranë.

Në këto kushte, vendimi për pezullimin e aplikimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, i cili është marrë me argumentin se, pala paditëse duhet të paraqiste pranë shoqërisë “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a. Tiranë, listën e plotë të aksionarëve me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe transferimin e aksioneve, gjen mbështetje në dispozitat e ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, si dhe pikën 3, të udhëzimit nr. 309, datë 03.06.2014 “Për regjistrimin e titujve në shoqërinë “Qendra e regjistrimit të aksioneve” sh.a. Tiranë, në të cilin parashikohet: “3. Në rastet e njoftimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të transferimit të aksioneve, shoqëria aksionare do të njoftojë edhe listën e plotë të aksionarëve të regjistruar më parë në shoqërinë “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a. Tiranë. Shoqëria, së bashku me bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, njofton listën e plotë të aksionarëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjithë aksionarëve të saj nga shoqëria “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a. Tiranë.

Përmbajtja e pikës 3, të udhëzimit nr. 309, datë 03.06.2014 “Për regjistrimin e titujve në shoqërinë “Qendra e regjistrimit të aksioneve” sh.a. Tiranë, është në koherencë me përmbajtjen e nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Pra, udhëzimi nr. 309, datë 03.06.2014 "Për regjistrimin e titujve në shoqërinë "Qendra e regjistrimit të aksioneve" sh.a. Tiranë, nuk rezulton të jetë një akt nënligjor, i cili cënon parimin e ligjshmërisë, ashtu siç ka pretenduar paditësi. Për rrjedhojë, kërkitimi i palës paditëse që ka të bëjë me shfuqizimin e vendimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit datë 21.10.2014, për pezullimin e aplikimit me numër çështje CN-669048-10-14, është i pabazuar në ligj dhe prova dhe si i tillë duhet rrëzuar.

Nga pala paditëse është pretenduar se "Qendra e regjistrimit të aksioneve" sh.a. Tiranë nuk rezulton të jetë as rregullisht e azhornuar pranë regjistrimit tregtar dhe as e licencuar nga ana e AMF, për veprimtarinë e regjistrimit të titujve.

Në këndvështrim dhe mbështetje të pikës 3, të nenit 35, të ligjit nr. 49/2012, paditësi nuk ka provuar para kësaj gjykate faktet e pretenduara dhe konkretisht moslicencimi nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare i "Qendrës së regjistrimit të aksioneve" sh.a. Tiranë.

Përsa i përket pretendimit tjetër të palës paditëse se, udhëzimi nr. 309, datë 03.06.2014 "Për regjistrimin e titujve në shoqërinë "Qendra e regjistrimit të aksioneve" sh.a. Tiranë, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 118, të Kushtetutës, pasi ligji nuk ka autorizuar nxjerrjen e këtij akti nënligjor, gjykata vlerëson se nuk është kompetente nga pikëpamja funksionale për të marrë në shqyrtim këtë pretendim të palës paditëse.

Në lidhje me kërkimin tjetër të palës paditëse që ka të bëjë me shfuqizimin e shkresës nr. 12738/1, datë 06.11.2014 të Drejtorit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për mospranimin e ankimit administrativ, gjykata i referohet nenit 2, të ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", në të cilin jepet kuptimi i aktit administrativ individual. Shkresa nr. 12738/1, datë 06.11.2014 e Drejtorit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nuk krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet akt administrativ individual. Me këtë shkresë njoftohet pala paditëse për shkaqet e marrjes së vendimit për pezullimin e aplikimit.

Në këto kushte, gjykata nuk mund të ndryshojë një shkresë të thjeshtë, e cila nuk konsiderohet akt administrativ, në kuptim të nenit 2, të ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

Përsa më sipër, gjykata vlerëson se kërkitimi i palës paditëse, për shfuqizimin e shkresës nr.12738/1, datë 06.11.2014 të Drejtorit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, nuk gjen mbrojtje juridike në ligjin nr. 49/2012, dhe si i tillë duhet vendosur rrëzimi i tij.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, gjykata arrin në konkluzionin se padia e paraqitur prej palës paditëse duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj dhe prova.

II. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit, mbi çështjet e faktit dhe të ligjit

Referuar shkaqeve të parashtruara në ankim nga pala e paditur, gjendjes në të cilën paraqiten rrethanat e çështjes, objektit dhe shkakut të padisë, vendimit të gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe argumenteve të dhëna prej saj në përgjigje të pretendimeve të palëve, Gjykata Administrative e Apelit (Në vijim Gjykata e Apelit/kolegji) vlerëson se, gjykata e shkallës së parë ka cilësuar drejt faktet dhe interpretuar korrekt ligjin kur ka arritur në përfundimin se padia e paditësit është e pabazuar dhe si e tillë duhet rrëzuar.

Në vlerësim të këtij kolegjii, shkaqet e ngritura në ankim nga pala paditëse kanë të bejnë si me cilësimin e fakteve ashtu edhe me menyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykata e shkallës së parë.

Rezulton se të gjitha pretendimet e ngritura në ankim nga pala paditëse janë parashtruar edhe si pretendime gjatë gjykimit në shkallë të parë, ku gjykata e shkallës së parë pasi i ka analizuar në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme i ka rrëzuar si të pabazuara në ligj.

Pala paditëse pretendon se, sipas Ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt", në regjistra regjistrohen titujt e dematerializuar, të cilët përfshihen në sisteme regjistrimi dhe janë të tregtueshëm në bursë nëpërmjet ofertës publike. Në rastin konkret, aksionet e emërtuara nga ana e Bankës Credins janë ato me ofertë private, të cilat janë në formë të materializuar dhe që transferimi i tyre është i ndërvarur nga miratimi i organeve vendimmarrëse të shoqërisë apo ato ligjore.

Sa i përket faktit nëse "titujt/aksionet", janë apo jo të materializuara (me oferte private apo ofertë publike), kjo nuk ndryshon rregullin e përcaktuar në nenin 123 e 126 të ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Per titujt", i cili përcakton qartësisht regjistrimin e titujve pavarësisht llojit në një regjistër të posaçëm i cili përmban dokument zyrtar dhe ligjor. Nëpërmjet këtij regjistri sigurohen në çdo kohë të dhëna të plota për pronësinë mbi titujt, si dhe kufizime të të drejtave të pronësisë mbi to.

Në zbatim të nenëve 123 e 126 të ligjit të lart cituar, MF ka nxjerrë një udhëzim të posaçëm për "*Për regjistrimin e titujve*", duke krijuar për këtë qëllim "*Qendrën e regjistrimit të aksioneve*" sh.a. Fakti që ligji parashikon regjistrimin e titujve në një regjistër, dhe krijimi i një subjekti të licencuar për këtë qëllim parashikohet shprehimisht në nenet 123 e 126 të ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008 "Per titujt".

Në këto rrethana, pretendimi tjetër i palës së paditur se ligji nuk parashikon regjistrimin e titujve në regjistrat para se të kryhet transaksione mbi keto tituj është tërësisht i pabazuar. I pabazuar gjendet edhe pretendimi tjetër i palës paditëse se udhëzimi nr. 309, datë 03.06.2014, në zbatim të të cilit pala e paditur ka nxjerrë aktin e pezullimit të rregjistrimit të kontratës së dhurimit të aksioneve, vjen në kundërshtim me ligjin si i tillë sipas palës paditëse bazuar në rregullat e gjykimit incidental. Ky udhëzim nuk duhej të zbatohet nga organi administrativ apo gjykata, por ato duhej të zbatonin drejt për drejt ligjin. Sikurse theksuam më sipër, udhëzimi në fjalë nuk vjen në kundërshtim me ligjin. Përkundrazi vetë ligji ka përcaktuar krijimin e një regjistri dhe menyrën e mbajtjes së tij. Udhëzimi nuk ka bërë gjë tjetër vecse ka detajuar rregullat mbi mbajtjen e regjistrit.

Për sa më sipër sikurse drejt ka konkluduar gjykata e shkallës së parë, akti i kundërshtuar në padi nga pala paditëse nuk vjen në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore apo nënligjore, si i tillë nuk ka arsye të shfuqizohet.

Gjykata e Apelit pajtohet me të gjitha konkluzionet e arritura nga gjykata e shkallës së parë si për çështjet e faktit ashtu edhe ato të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, për pasojë vendimi i saj duhet të lihet në fuqi si një vendim i drejtë i bazuar në ligj e prova.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 50, germa "b", të Ligjit Nr. 49, datë 03.05.2012

VENDOSI

- Lënien në fuqi të vendimit Nr. 223, datë 27.01.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot me datë 12.09.2017.

Anëtar

Amarildo LAÇI

d.v

Anëtare

Lindita SINANAJ

d.v

Kryesues

Bari SHYTI

d.v

e njëhsuar me origjinalin

*Kancelari
Leonard Steatij
Steatij*